



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Përgjigje nga Bashkia Tiranë

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>

Thu, Mar 7, 2024 at 2:25 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Përsëndetje,

Në vijim të kërkesës suaj ardhur pranë Bashkisë Tiranë dhe protokolluar me nr. prot. Q-3017, datë 21.02.2024, ju informojmë se ka përgjigje nga strukturat si më poshtë vijon:

“Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ju vendos në dispozicion informacionin e kërkuar në kërkesë duke ju sqaruar se për llogaritjen e banesave sociale në favor të Bashkisë Tiranë, jemi mbështetur në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” ka hyrë në fuqi në datën 01.12.2018, i cili përcakton se: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale.” dhe VKB nr.105, datë 25.10.2019, “Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Tiranë nga ndërtimet reja”

Për këtë arsye informacioni i dhënë nëpërmjet kësaj shkrese i përket periudhës mbas hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar deri në fund të vitit 2023.

Për vitin 2019, 32% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.

Për vitin 2020, 29% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 6% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2021, 35% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 9% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2022, 69% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 3% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2023, 65% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 2% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Përsa i përket informacionit që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, ju vendosim në dispozicion si më poshtë përgjigjen mbi të ardhurat e grumbulluara për kontributin 3% banesa sociale:

Të ardhurat për vitin 2020 : 360,975,000 Lekë

Të ardhurat për vitin 2021 : 496,746,000 Lekë

Të ardhurat për vitin 2022 : 959,850,000 Lekë

Të ardhurat për vitin 2023 : 893,830,000 Lekë”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju urojmë ditë të mbarë

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Bashkia Tiranë

Sheshi "SKËNDERBEJ",
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Web: www.tirana.al

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-3017 / prot. 2

Tiranë, më 22 / 03 / 2024

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7,
Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-3017, datë 21.02.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Monitorimit të Territorit ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. Q-3017/2 prot., datë 07.03.2024 si vijon:

"Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, ju bëjmë me dije se Drejtoria e Monitorimit të Territorit, ju vendos në dispozicion informacionin e kërkuar në pikën 1 të kërkesës tuaj duke ju sqaruar se për llogaritjen e banesave sociale në favor të Bashkisë Tiranë, jemi mbështetur në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social" ka hyrë në fuqi në datën 01.12.2018, i cili përcakton se "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale" dhe VKB Nr.105, datë 25.10.2019, "Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Tiranë nga ndërtimet reja".

Për këtë arsye informacioni i dhënë nëpërmjet kësaj shkrese i përket periudhes mbas hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar deri në fund të vitit 2023.

Për vitin 2019, 32% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.

Për vitin 2020, 29% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 6% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2021, 35% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 9% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2022, 69% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 3% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare.

Për vitin 2023, 65% e lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë e kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare dhe 2% në mënyrë të kombinuar në sipërfaqe banimi dhe diferencën në vlerë monetare”.

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Përgjigje nga Bashkia Tiranë

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>
To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Wed, Mar 20, 2024 at 3:25 PM

Përhëndetje,

Në lidhje me pyetjen se për çfarë janë përdorur të ardhurat nga taksa e strehimit social, ju bëjmë me dije se ka përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar si vijon:

"Ky fond nuk është përdorur dhe është pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë në programin e strehimit social me emërtimin "Investime për ndërtimin e banesave sociale referuar kontributit të sektorit privat".

Ju falemnderojmë për mirëkuptimin.

Me respekt

[Quoted text hidden]

[Quoted text hidden]